



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:200971
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05441198

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorëve A.H., Z.O., dhe V.N., që të gjithë nga Gjakova, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj avokat në Prishtinë, kundër debitorës së përmbarimit Komunës së Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për përmbarimin e dokumentit të ekzekutueshëm – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.1338/21 të datës 14.12.2022, për shkak të kompensimit e ushqimit në punë si dhe të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në shumën e përgjithshme prej 2,444.00 euro, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhironlogarisë bankare, jashtë seancës gjyqësore, më 12 mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. URDHËROHET Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me Aktvendimin e kësaj gjykate, 2021:200971 të datës 30.03.2023, për lejimin e përmbarimit të dokumentit të ekzekutueshëm - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1338/21, të datës 14.12.2022, për shkak të kompensimit e ushqimit dhe udhëtimit në punë, dhe për klasë të kombinuar, dhe atë:

- kreditorit A.H., nga Gjakova, t’ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 80.00 euro,
- kreditores Z.O., nga Gjakova, t’ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 214.00 euro,

- kreditores V.N., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 228.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përbarimore në shumën prej 1,922.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 2,444.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, në atë mënyrë që nga xhirollogaria e debitores së përbarimit, Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të barten këto mjetet monetare, në llogarinë e të autorizuarit të kreditoreve avokat Arben Biblekaj, në xhirollogarinë e tij bankare, me Nr....., në Bankën Kombëtare Tregtare-BKT.

II. OBLIGOHET pala kreditore dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën ta njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

A r s y e t i m

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të kreditores së përbarimit, me aktvendimin 2021:200971, të datës 30.03.2023, ka lejuar përbarimin ndaj debitores Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit. Ndaj këtij aktvendimi, debitorja ka ushtruar prapësim me datë 18.04.2023, ndërsa i autorizuari i kreditoreve me datë 24.04.2023 ka paraqitur përgjigje në prapsim. Duke vendosur lidhur me prapësimin e debitores, gjykata me aktvendim 2021:200971, të datës 02.11.2023 ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e lartcekur.

Meqenëse palët kreditore në propozimin e tyre për përbarim, kanë cekur mjetin e përbarimit - transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare e me qëllim të realizimit të detyrimit të lartë cekur në të holla, dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret, A.H., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 80.00 euro, kreditores Z.O., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 214.00 euro, kreditores V.N., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 228.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përbarimore në shumën prej 1,922.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 2,444.00 euro, dhe atë për këto arsye:

Nga shikimi i shkresave të lëndës, 2021:200971, kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti i përbarimit – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1338/21, të datës 14.12.2022, i plotfuqishëm me datë 29.12.2022, dhe i

ekzekutueshëm me datë 11.01.2023, për shkak të detyrimit në të holla, duke u bazuar në dokumentin e lartcekur të përmbartimit, si dhe nenin 152 të LPP-së, debitorja, është e obliguar që kreditoreve të përmbartimit, t'ia paguaj shumat e lartcekura të gjitha në afat prej 7 ditësh, andaj në arsyet e cekura më lart kjo gjykatë, vendosi që ta urdhëroj Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, gjykata duke u bazuar në nenet 3, 5 par.6 pika 2, 109 par.3, 113 dhe nenin 152 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

- Departamenti i Përgjithshëm-

2021:200971, më 12 mars 2024

GJYQTARI,

Durim BALAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e veçantë.